



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri**

**RAPORT I KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI NË
KËSHILLIN E PËRHERSHËM TË OSBE-SË, 25 MAJ 2006**

1. HYRJE

Raporti i fundit i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri u prezantua në qershor 2005, dhe, në korrik të po këtij viti u zhvilluan zgjedhjet e rëndësishme parlamentare. Procesi zgjedhor ishte "i tejzgjatur dhe, ndonjëherë, i pasigurtë", siç është shprehur Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Raportin e tij Përfundimtar të 7 nëntorit 2005. Megjithatë, procesi në përgjithësi ishte i qetë dhe rezultati u respektua. Rezultatet përfundimtare konfirmuan fitoren në zgjedhje të koalicionit të djathtë udhëhequr nga Partia Demokratike (PD) nën drejtimin e Profesor Sali Berishës. Zgjedhjet sollën një qeveri të re me një përjasje më të vendosur dhe dinamike ndaj reformave në vend, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, nxitjes së rritjes ekonomike dhe sociale dhe përshejtit të integritetit Euro-Atlantik të Shqipërisë. Nënshkrimi së shpejti i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE) mund të interpretohet si një njohje e përparimit thelbësor që po bëhet.

Megjithatë, Qeverisë i është dashur të merret me një trashëgimi dhe sfida jo të lehta: pas tetë vjetësh në opozitë, asaj i është dashur të fillojë të drejtojë administratën që ishte kishte rënë në pasivitet gjatë periudhës dymujore *inter-regnum* pas zgjedhjeve në verën e vitit 2005; ajo ka nisur një ristrukturim ambicioz të ministrive; i është dashur të kapërcejë krizën energjetike për shkak të neglizhencës së monopolit shtetëror në vjeshtën e vitit 2005; i është dashur të përgatisë buxhetin e shtetit duke kërkuar që të ruajë rritjen, stabilitetin makroekonomik dhe të shmangë tensionet sociale. Qeveria ka bërë, gjithashtu, përpjekje që të mobilizojë të trija degët e pushtetit për të vepruar kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në fushat që mbulon mandati i Prezencës, administrata e re ka shfaqur gatishmëri për të punuar më afër me Prezencën. Veprimtaritë e ndërmarra nga Prezenca përkruhen më me hollësi më tej në këtë raport dhe ato janë zhvilluar në konsultim dhe bashkëpunim të ngushtë me qeverinë dhe partnerët e tjerë në Shqipëri, si dhe në bashkërendim me donatorë ndërkombëtarë. Në zhvillimin e veprimtarive të saj gjatë periudhës për të cilën raportohet, si dhe për planifikimin e veprimtarive për vitin 2007, Prezenca ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë parasysh plotësisht përparësitë e deklaruara të qeverisë dhe do të përpiqet që të shmangë duplikimin e veprimtarive me partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

Vlen të theksohet se, që nga muaji shtator 2005, Qeveria ka filluar të marrë një zotërim më të madh në fushën e bashkërendimit të donatorëve dhe ka marrë drejtimin në zbatimin e proceseve të planifikimit dhe hartimit të buxheteve që kanë lidhje me të. Fakti që pothuajse i gjithë kabineti qeveritar ishte i pranishëm në tryezën e fundit të rumbullakët të donatorëve zhvilluar në Tiranë më 6 maj 2006 tregon qartë përkushtimin e Qeverisë në marrëdhëniet e saj me komunitetin e donatorëve ndërkombëtarë. Një arritje e dukshme e Qeverisë në këtë fushë ka qenë zhvillimi i Sistemit të Planifikimit të Integruar, një mekanizëm politikbërës hartuar për të rritur efektivitetin e ndërveprimit mes Qeverisë e donatorëve dhe proceset e planifikimit që

lidhen me të. Para nënshkrimit të pritshëm të MSA-së në qershor 2006, qeveria ka dhënë sinjale të dëshirës së saj që partnerët e saj ndërkombëtarë t'i vendosin veprimtaritë e programeve në përputhje me përparësitë e Qeverisë.

Përmbledhja e veprimtarive të Prezencës që nga qershori 2005 duhet të paraprihet nga një shënim rreth dy vizitave zyrtare të OSBE-së në Shqipëri, të cilat, që të dyja, ndihmuan në rritjen e profilit të OSBE-së, dhe, ajo që është më e rëndësishme, në çimentimin e marrëdhënieve të saj me Shqipërinë. Në prill 2006, Kryetari i Radhës së OSBE-së, Ministri i Punëve të Jashtme të Belgjikës, Karel De Gucht, vizitoi Shqipërinë, dhe zhvilloi takime me Presidentin e Republikës, Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme. Ministri De Gucht bëri thirrje për fillimin e procesit të reformës zgjedhore, dhe përshëndeti qeverinë për përpjekjet e saj në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ai, gjithashtu, përgëzoi Shqipërinë për nënshkrimin së afërmi të MSA-së. Para vizitës së Kryetarit të Radhës, Prezenca priti Raporterin e Komisionit Politik të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, Z. Wolfgang Grossruck nga Austria, i cili u takua me Kryeministrin dhe Kryetaren e Kuvendit.

2. MOMENTET KRYESORE POLITIKE

Ngjarja më e rëndësishme politike gjatë periudhës për të cilën po raportohet ishin zgjedhjet parlamentare të korrikut 2005. Sipas raportit përfundimtar të OSBE/ODIHR-it, publikuar në nëntor 2005, zgjedhjet u gjykuan se kishin arritur pjesërisht standardet ndërkombëtare dhe se “u përputhën, vetëm pjesërisht, me angazhimet e OSBE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike”. Parregullsitë në votime dhe shformimet që erdhën si pasojë e skemave të votimit strategjik, ashtu si dhe procesi i tejzgjatur zgjedhor, nxorën në pah nevojën për vazhdimin e reformës zgjedhore dhe zvogëlimin e ndërhyrjes së partive politike në procesin zgjedhor. Qeveria e re, që nisi nga puna në fillim të muajit shtator 2005, deklaroi qëllimin e saj për të garantuar që zgjedhjet e ardhshme të arrinin standardet ndërkombëtare dhe ka shprehur vazhdimisht angazhimin e saj për të zbatuar rekomandimet e OSBE/ODIHR-it në kryerjen e reformës zgjedhore.

Me ardhjen në pushtet, Qeveria deklaroi se qëllimet e saj kryesore ishin të luftonte nivelet dominuese të korrupsionit, si dhe të ndërmerre një fushatë të efektshme kundër krimit të organizuar. Në të dyja fushat, Qeveria ka vepruar me forcë. Në mars 2006, grupi mbikëqyrës qeveritar për firmat piramidale paditi ish-kryetarin e tij, ndërsa kompania shtetërore e telekomunikacionit filloi ndjekjen penale kundër ish-punonjësve të saj – që të gjitha me akuza për korrupsion. Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dha mendimin e tij mbi projektligjin e Qeverisë për heqjen e imunitetit të deputetëve me qëllim ndjekjen e tyre penale për raste korrupsioni – verdikt që ishte gjerësisht në përputhje me mendimin e Qeverisë. Në prill 2006, Kontrolli i Lartë i Shtetit e kritikoi Qeverinë e mëparshme për parregullsi në prokurime, ndërsa Kuvendi miratoi një ligj për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit, ku qytetarët mund të raportojnë drejtpërsëdrejti për raste të dyshuara korrupsioni.

Veçanërisht e suksesshme ka qenë fushata qeveritare kundër krimit të organizuar, ku janë arrestuar disa banda të njohura kriminale. Arritjet janë mirëpritur nga publiku dhe atmosfera e sigurisë është përmirësuar ndjeshëm. Në mars 2006, policia arrestoi drejtuesin dhe gjashtë anëtarë të tjerë kryesorë të një bande kriminale në Lushnje, kurse në Tropojë u arrestuan dy anëtarët e fundit të një bande të njohur që ishin të lirë që nga

viti 1997. Në luftën kundër drogës, policia ka raportuar raste në rritje të kapjes së heroinës dhe kanabisit, arrestimin e të dyshuarve të implikuar dhe sekuestrimin e aseteve të kriminelëve. Përsa u përket masave kundër trafikimit, në prill 2006, Kuvendi miratoi një ligj të prozuar nga qeveria, që ngjalli shumë diskutime, për një moratorium trevjeçar për të gjitha mjetet motorike lundruese për të parandaluar trafikimin e drogës dhe qenieve njerëzore në rrugë detare.

Me ardhjen në pushtet, Qeveria ka ngritur publikisht shqetësime rreth aftësisë së Prokurorit të Përgjithshëm për të përmbushur rolin e tij në mënyrë efektive, duke pasur parasysh shkallën aktualisht të ulët të hetimeve penale, ndjekjeve dhe vendimeve gjyqësore për të luftuar korrupsionin. Në prill 2006, Kuvendi vendosi të veprojë në bazë të një kërkesë që një komision parlamentar hetimor të hetojë punën e Prokurorisë. Ky komision pritet të raportojë në Kuvend në qershor 2006.

Gjithashtu, Qeveria ka filluar të merret edhe me problemin shumë të përhapur të ekstralegalitetit në pronat e paluajtshme. Pas disa ndryshimesh të njëpasnjëshme dhe vetos së Presidentit, Kuvendi miratoi ligjin e propozuar nga Qeveria për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje në prill 2006. Ligji duket t'iu ofrojë mundësinë pronarëve të paligjshëm, që mendohet të jenë më shumë se 200 000, të legalizojnë ndërtesat e tyre dhe shfrytëzimin e këtyre ndërtesave, përfshirë edhe përdorimin si asete për ngritje kapitalesh, ashtu si edhe krijimin e një tregu të ri strehimi brenda periferive të qyteteve kryesore. Zbatimi i tij ka vonuar pjesërisht procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe do të kërkojë asistencë ndërkombëtare. Teksti përfundimtar i ligjit përfshiu disa nga komentet e bëra nga Prezenca.

Gjithashtu, Qeveria ka filluar të bëjë ndryshime në organet rregullatore të medias me qëllimin e shprehur të luftës kundër piraterisë dhe praktikave të tjera të paligjshme. Ajo ka bërë ristrukturimin dhe modernizimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT) dhe Këshillit Drejtues të Radios dhe Televizionit Publik. Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias dha disa komente mbi projektligjin në mars 2006, të cilat, si Qeveria ashtu edhe opozita, i interpretuan se mbështesnin pozicionin e vet. Ndryshimet e bëra në ligj u miratuan përmes një tjetër polemike me opozitën. Përzgjedhja e anëtarëve të këtyre organeve rregullatore të ristrukturuara ka të ngjarë të rrisë larminë dhe përfaqësueshmërinë e tyre, nëse kjo menaxhohet siç duhet.

Situata e përgjithshme politike filloi të polarizohet më shumë në fund të vitit 2005, më dukshëm, për shkak të polemikave që filluan të shpalosen midis Qeverisë dhe Bashkisë së Tiranës në lidhje me disa punë publike të bëra dhe të financuara nga kjo e fundit. Qeveria i konsideroi këto ndërtime të paligjshme dhe urdhëroi hetimin, pezullimin dhe përfundimisht prishjen të tyre.

Që në fillim të vitit 2006, situata është ndikuar nga një ngërç politik në Kuvend. Shkaku fillestar i mosmarrëveshjes ishte kërkesa e opozitës për të votëbesuar Kryetaren e Kuvendit me fletë-votimi të fshehtë. Kjo gjë u refuzua dy herë nga koalicioni qeverisës, në një votim me standarde procedurale të dyshimta dhe, si rezultat, opozita nisi një fushatë pengimi dhe mosbindjeje në Kuvend. Megjithatë në fund u arrit në konsensus¹,

¹ Për votime specifike në Kuvend, do të përdoret votimi i fshehtë me fletë deri në instalimin e një sistemi të ri votimi elektronik. Prezenca është duke planifikuar ofrimin e një asistence nga ana e saj për të identifikuar e për të instaluar një sistem të tillë duke përdorur fonde nga Projekti i saj jashtëbuxhetor për Forcimin e Kapaciteteve të Kuvendit.

ky ngërç i pengoi përpjekjet e Kuvendit për t'u marrë me çështje të rëndësishme si reforma zgjedhore dhe çoi në një polarizim të padobishëm të skenës politike.

Përsa i përket reformës zgjedhore, më 7 dhjetor 2006, Presidenti i Republikës Alfred Moisiu, që, tradicionalisht, ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndërtimin e konsensusit në çështje zgjedhore, mblodhi një tryezë të rrumbullakët të partive politike parlamentare për të theksuar urgjencën e fillimit të procesit. Në fund të tryezës së rrumbullakët, të gjithë të pranishmit dolën me një deklaratë, që shprehte gatishmërinë për të filluar reformën zgjedhore, nëpërmjet krijimit të një komisioni parlamentar me pjesëmarrjen e të gjitha partive parlamentare në dhjetor 2005. Megjithëse komisioni i posaçëm parlamentar u ngrit në janar 2006, mosmarrëveshjet për të drejtën e vetos për dy partitë e mëdha dhe përbërja e komisionit vazhduan të bllokojnë punimet e komisionit, mandati i të cilit skadoi në prill 2006. Partitë politike kanë vazhduar të konsultohen në lidhje me ringritjen e komisionit dhe, së fundmi, janë vënë re disa konvergime pozicionesh. Megjithatë, deri në përgatitjen e këtij raporti, nuk është arritur ndonjë marrëveshje përfundimtare. Kështu, ende nuk ka një platformë për të vazhduar punën për reformën zgjedhore.

3. PIKAT KRYESORE TË VEPRIMTARISË SË PREZENCËS

Puna e Prezencës në Shqipëri gjatë gjithë periudhës së raportimit ka ndjekur linjat kryesore të mandatit të saj. Veprimtaritë kryesore përfshijnë reformën zgjedhore dhe mbështetjen për përgatitjen dhe monitorimin e zgjedhjeve të përgjithshme të korrikut 2005, asistencën në reformën gjyqësore dhe atë të pronave, forcimin e kapaciteteve të Kuvendit të Shqipërisë dhe mbështetjen për Policinë Kufitare. Gjithashtu, ajo vazhdoi të luajë rolin e saj drejtues për bashkërendimin e donatorëve, në Shqipëri së bashku me PNUD-in, Bankën Botërore dhe Komisionin Evropian.

Prezenca ka ristrukturuar disa nga programet dhe departamentet e saj kryesore, së bashku me Planin e Programeve dhe Projekt-Buxhetin për vitin 2006. Në vitin 2006, ajo filloi punën me dy programe të reja tematike nën departamentet përkatëse, atë të Dimensionit Njerëzor dhe të Mirëqeverisjes në Çështjet Ekonomike dhe Mjedisore. Që të dy këto departamente u krijuan duke ristrukturuar programet/departamentet e mëparshme të Demokratizimit dhe të Shtetit të së Drejtës. Drejtimi i katër zyrave rajonale të Prezencës, të cilat Prezenca propozon t'i kthejë në zyra projektesh në vitin 2007, është përqendruar nën zyrën e Kryetarit të Misionit. Është përfunduar hartimi i buxhetit përkatës dhe rekrutimi, si dhe është përgatitur transferimi i zyrave qendrore të Prezencës në mjedise me kosto më të ulët dhe shpenzime më të vogla mirëmbajtjeje.

Buxheti thelbësor i Prezencës për vitin 2006 pati një rritje modeste prej më pak se 4% krahasuar me vitin e mëparshëm, duke arritur deri në 3.8 milion euro, me qëllim pasjen e më shumë burimeve për punë tematike. Megjithatë, kjo pjesërisht u kompensua prej rritjes së kostove të personelit për shkak të rritjes së dietave për personelin ndërkombëtar. Kapaciteti i planifikuar prej 120 punonjësish në vitin 2005 dhe 110 në vitin 2006 nuk është arritur asnjëherë plotësisht, kryesisht, për shkak të lëvizjeve të personelit, përfundimit brenda afateve të shkurtra të kontratave të disa punonjësve ndërkombëtarë të dërguar nga vendet e tyre dhe periudhave shpesh të tejjzgjatura të vendeve vakante dhe marrjes në punë të njerëzve të rinj. Prezenca ka administruar burime relativisht të konsiderueshme fondesh të ofruara nga donatorë të ndryshëm në

projekte jashtëbuxhetore shumëvjeçare. Për këto projekte, Prezenca arriti të disbursojë fonde donatorësh në vitin 2005 në shumën neto prej gati 2.3 milion euro.

4. BASHKËPUNIMI PËR SIGURINË

4.1. Asistenca për Policinë

Duke punuar afër me Qeverinë dhe Misionet e Komisionit Evropian dhe ato të Shteteve të Bashkuara, që ofrojnë Asistencë për Policinë, Prezenca është përqendruar në asistencën për policinë – Policinë e Shtetit dhe Policinë Kufitare. Prezenca përfundoi një projekt të realizuar me fonde jashtë buxhetit të saj, nëpërmjet të cilit iu siguroi pikave kryesore të kalimit të kufirit disa gjeneratorë me energji diellore dhe i dorëzoi Policisë Kufitare dhe Migracionit pajisjet përkatëse. Këto pajisje do të sigurojnë komunikim të pandërprerë midis autoriteteve lokale dhe atyre qendrore të policisë, si dhe furnizim pa ndërprerje me energji elektrike për pikat e kalimit të kufirit që do të ndihmojë në regjistrimin e kompjuterizuar të automjeteve.

Prezenca përfundoi trajnimin e 102 efektivave të Policisë Shqiptare të Kufirit dhe Migracionit nga njëmbëdhjetë qytete për përdorimin e pajisjeve të vëzhgimit të kufirit. Programi i trajnimit u zbatua në partneritet me Programin e Asistencës për Trajnim të Misionit të OSBE-së në Gjeorgji dhe përfundoi në mars 2006. Programi do të finalizohet duke i dorëzuar policisë pajisjet e vëzhgimit gjatë natës. Duke pasur parasysh nevojën për një komunikim ndërkufitar më intensiv, qeveria identifikoi si përparësi trajnimin e oficerëve të policisë kufitare për të fituar njohuri në gjuhë të huaja. Në bashkëpunim me Këshillin Britanik, në janar 2006, Prezenca filloi trajnimin në gjuhën angleze. Ky projekt do të përfundojë në dhjetor 2006 me trajnimin e dyqind oficerëve të policisë.

Me kërkesë të Kuvendit të Shqipërisë dhe në kuadrin e promovimit të mbikëqyrjes parlamentare për luftën kundër krimit të organizuar, Prezenca, së bashku me Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore dhe partnerët austriakë, organizoi një seminar rajonal për angazhimin e parlamentarëve të Evropës Juglindore në luftën kundër krimit të organizuar. Ky seminar u zhvillua në Tiranë në prill 2006 dhe në të folën Kryeministri dhe Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë.

Me kërkesë të Policisë së Shtetit, Prezenca po asiston fushatën e autoriteteve shqiptare kundër kultivimit të *cannabis sativa*, duke siguruar financim dhe prodhim të fletëpalosjeve, posterave dhe spoteve televizive në mbarë vendin. Prezenca ka organizuar, gjithashtu, debate lokale në ato zona të vendit ku dihet se kultivohet *cannabis sativa*.

Prezenca ka vazhduar të ndihmojë për organizimin e takimeve të përbashkëta ndërkufitare çdo dy javë me Kosovë/Serbi dhe Mali i Zi (SMZ) për përfaqësuesit e Policisë Shqiptare të Kufirit, Shërbimit Policor Kosovë/SMZ, KFOR, UNMiK, dhe OMiK. Niveli i bashkëpunimit të këtyre takimeve ka kontribuar në luftën kundër krimit në të dyja anët e kufirit. Prezenca ka mbështetur gjithashtu edhe takime sistematike ndërkufitare mes kryetarëve të bashkive të Kosovë/SMZ, Serbi dhe Mali i Zi dhe Shqipërisë. Në prill 2006, këto takime u zgjeruan duke përfshirë për herë të parë edhe kryetarë bashkie nga bashkitë kufitare të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Në kuadrin e programit të saj të bashkëpunimit për sigurinë, Prezenca ka asistuar më tej Qeverinë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit dhe Planit të Veprimit për të luftuar trafikimin e qënieve njerëzore dhe për të mbrojtur viktimat. Një projekt i menaxhuar bashkërisht nga UNHCR-ja, IOM-i dhe Prezenca për Përzgjedhjen e Unifikuar të Huajve të Parregullt përfundoi në mars 2006. Ky projekt përfshinte një sërë seancash trajnimi dhe asistencë teknike për të rritur kapacitetin e policisë kufitare përsa i përket zbatimit të sistemit të përzgjedhjes. Autoritetet shqiptare kanë marrë plotësisht në dorëzim procesin e përzgjedhjes së azilkërkuesve.

5. QEVERISJA NË ÇËSHTJE TË EKONOMISË DHE MJEDISIT

Ky program i krijuar rishtazi shkriu elemente të programeve të mëparshme të Demokratizimit dhe Zyrës për Shtetin e së Drejtës në një paketë më koherente veprimtarish, që kanë të bëjnë me mirëqeverisjen në çështje të ekonomisë dhe mjedisit, reformës për pronat dhe aspekte të antitrafikimit.

5.1. Reforma për pronat

Që prej fundit të vitit 2004, Prezenca, në bashkëpunim me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) të Shqipërisë ka ndihmuar në rritjen e kapaciteteve të ZRPP-së dhe procesin e regjistrimit të parë në zona të përzgjedhura me përparësi, me financime të konsiderueshme jashtë buxhetit qendror të dhëna nga Norvegjia dhe Finlanda. Regjistrimi i parë i pronës është procesi i përgatitjes së hartave dhe regjistrimi i të gjitha të drejtave ligjore mbi pronat e paluajtshme. Pa përfundimin e regjistrimit, nuk mund të përcaktohen të drejtat ligjore mbi pronat shtetërore dhe private, si dhe kufijtë e tyre, gjë që përbën një pengesë për investime. Duke përdorur procedura standarde për tenderim dhe sigurim të cilësisë, Prezenca ka lidhur kontrata për regjistrimin e rreth 30 000 pronave në tre rrethe. Planifikimi i ardhshëm i procesit të regjistrimit vazhdon dhe përfshin konsultime me Bankën Botërore dhe partnerë të tjerë.

Prezenca, me financim nga Shtetet e Bashkuara, ka vazhduar të punojë me Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave për të ndërtuar më tej kapacitetin e tij në zbatimin e ligjit të kthimit dhe kompensimit. Komiteti Shtetëror ka punuar për përcaktimin e një metodike për përllogaritjen e vlerës së pronës, që do të kompensohet nga ligji dhe projekti ka siguruar ekspertizë ndërkombëtare në këtë proces. Ai ka ndihmuar në përgatitjen e një harte për vlerësimin e pronës për zonën urbane të Tiranës, që përbën një kriter për përllogaritjen e vlerës së pretendimeve mbi pronën që duhet kompensuar dhe ka ndihmuar Komitetin Shtetëror në zbatimin e një projekti pilot për testimin e metodikës, që do të përcaktojë vlerën e tokës bujqësore dhe turistike. Sigurimi i hartave të vlerësimit do të nevojitet për të vazhduar më tej me zgjidhjen e pretendimeve për kthim dhe kompensim të paraqitura prej një kohe të gjatë dhe do të ketë, gjithashtu, vlerë në procesin e legalizimit të më shumë se 200 000 ndërtesave pa leje.

5.2. Mjedi

Në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit të Çështjeve Ekonomike dhe Mjedisore (OCEEA), Prezenca ka ndjekur programin nën-rajonal për sigurinë mjedisore dhe po përgatit një program që do të promovojë objektivat e Konventës së Aarhus-it në partneritet me Ministrinë e Mjedisit (MM). Prezenca është e përfshirë në disa veprimtari ndërgjegjësuese për mjedisin të bashkëorganizuara me Qeverinë dhe shoqërinë civile. Me mbështetjen e MM-së, Prezenca ndihmoi për organizimin e Ditës së Qyteteve të

Pastra në shtator 2005 në gjashtë bashki, me qëllim ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Prezenca zbatoi një projekt për një sistem të riciklimit të mbetjeve në gjashtë shkolla në Tiranë dhe mbështeti këtë projekt me mbjelljen e pemëve dhe shpërndarje të literaturës për informim publik.

5.3. Ekonomia

Në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, një agjenci gjermane për zhvillim dhe OCEEA-në, Prezenca ka drejtuar një program për nxitjen e konkurrencës së biznesit dhe politikat e punësimit për gra të reja dhe grupet e pambrojtura. Janë dhënë 44 çmimet e para për propozime për hapjen e një biznesi nga qarku i Shkodrës. Prezenca ndihmoi Bashkinë e Shkodrës duke mobilizuar mbështetje nga donatorët në përpjekjet e saj për të përgatitur një plan strategjik për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni. Në dhjetor 2005, nëpërmjet Qendrave lokale të Zhvillimit të Shoqërisë Civile, Prezenca përmbylli një seri prej dymbëdhjetë seminaresh ndërgjegjësuese mbi angazhimet e Shqipërisë në kuadrin e Organizatës Botërore të Tregtisë. Prezenca mbështeti publikimin e një udhëzuesi për të ndihmuar bizneset që të jenë më konkurrense në nivel ndërkombëtar.

5.4. Mirëqeverisja

Prezenca ka bërë disa konsultime me Qeverinë në lidhje me mënyrat e mbështetjes së luftës së kësaj të fundit kundër korrupsionit. Kontaktet pritet të sjellin një kuptim të qartë lidhur me atë se nëse dhe se si do të dëshirojë Qeveria ta përdorë asistencën e OSBE-së në këtë fushë. Prezenca ka përfshirë elemente antikorrupsioni në veprimtaritë e saj të regjistrimit të pasurisë, që janë hartuar për të shtypur potencialin për korrupsion, duke iu përmbajtur shërbimeve standarde të procedurave të prokurimit dhe regjistrimit si dhe brenda punës së saj për nxitjen e standardeve më të larta etike dhe profesionale të gjyqësorit.

Brenda mandatit të saj për mirëqeverisje, Prezenca ka mbështetur programin Sistemi i Referimit të Udhëheqjes (*Leadership Benchmark*), hartuar dhe drejtuar nga Këshilli i Evropës, me pjesëmarrjen e Shoqatës së Kryebashkiakëve të Shqipërisë. Projekti synon të ndihmojë zyrtarët e zgjedhur në nivel vendor që të vlerësojnë efektshmërinë e tyre në aftësi drejtuese, ofrimin e shërbimeve dhe pjesëmarrjen e komunitetit. Në vazhdim, njësitë e qeverisjes vendore do të mund të krahasojnë punën e tyre me kriteret për një autoritet vendor *ideal*.

Në bashkëpunim me Bashkinë e Krujës, Prezenca finalizoi projektin për hartimin e një faqeje interneti me qëllim përmirësimin e komunikimit të saj me qytetarët, duke iu dhënë këtyre të fundit mundësi për të marrë informacion mbi bashkinë. Faqja e internetit do t'i japë mundësi Krujës të promovojë potencialin e saj turistik, dhe, për këtë qëllim, faqja e internetit do të përmbajë, gjithashtu, hapësirë për veprimtaritë aktuale kulturore, hotelet dhe restorantet.

5.5. Lufta kundër trafikimit

Në kuadrin e një projekti të drejtuar nga OCEEA-ja dhe me mbështetjen e Ministrisë së Turizmit, në tetor 2005 Prezenca hartoi një Kod Sjelljeje për operatorët turistikë dhe ua paraqiti operatorëve turistikë kryesorë për komente. Kodi ishte pjesë e projektit për promovimin e vetërregullimit në sektorin e turizmit në Shqipëri për reduktimin e përdorimit të forcës së punës të trafikuar, përfshirë shfrytëzimin e fëmijëve. Faza e dytë

do të përqendrohet në organizimin e nënshkrimit të Kodit të Etikës nga të gjithë aktorët kyç me publikimin e tij për publikun e gjerë.

6. DIMENSIONI NJERËZOR

Puna e Prezencës është përqendruar në reformën legislative dhe gjyqësore, reformën zgjedhore dhe veprimtari të lidhura me të, ndërtimin e kapaciteteve të Kuvendit, mbështetje për shoqërinë civile dhe zhvillimin e medias.

6.1 Reforma e gjyqësorit

Prezenca ka vazhduar programet e saj tematike për zhvillimin e gjyqësorit të drejtë dhe drejtësisë për të miturit që përfshijnë një sërë veprimtarish të veçanta. Në bashkëpunim me Shkollën shqiptare të Magjistraturës dhe homologen e saj franceze, në tetor 2005, Prezenca organizoi disa seminare mbi drejtësinë për të miturit, trajtuar nga gjyqtarë të lartë francezë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga sistemi shqiptar i drejtësisë për të mitur. Seminaret synonin ndërgjegjësimin e zyrtarëve e drejtësisë për të mitur në lidhje me përgjegjësitë e tyre ndaj të miturve.

Me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë (MD), në tetor 2005, Prezenca paraqiti një studim për zvogëlimin e vonësve në gjykimet penale. Në nëntor 2005, Prezenca financoi një seminar trajnimit për nëpunësit e gjykatës që punojnë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda (GJKR) në Tiranë, për t'iu dhënë nëpunësve një kuptim më të qartë të rolit të tyre dhe të koncepteve të gjyqësorit të drejtë, mbrojtjes së dëshmitarit dhe çështjeve të sigurisë. Si pjesë e projektit të ndërtimit të kapaciteteve të GJKR-së, Prezenca publikoi një udhëzues për të rritur informacionin mbi mënyrën e zhvillimit të gjyqësorit të drejtë dhe rregullat që kanë të bëjnë me dëshmitarët.

Me synim rritjen e efektshmërisë nëpërmjet bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimit të praktikave më të mira, në tetor 2005, Prezenca organizoi një vizitë studimore për zyrtarë të drejtësisë shqiptare në Ministrinë italiane të Drejtësisë. Financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës, vizita kishte për synim prezantimin e praktikave italiane të përfshirjes së publikut në procesin e rishikimit të legjislacionit. Në nëntor, Prezenca i dhuroi GJKR-së kompjutera dhe programe kompjuterike për përdorim në sallat e gjyqësorit pajisje që do të mundësojnë personelin e GJKR-së të jetë më i efektshëm në përgatitjen e vendimeve gjatë seancave gjyqësore. Gjithashtu, u krijua një dhomë për dëshmitarët me qëllim rritjen e sigurisë së dëshmitarëve. Së fundi, GJKR-ja ka hapur një faqe interneti, që jep hollësi mbi gjykimet aktuale dhe ato të pritshme, si dhe vendime gjyqësore. Kjo është financuar nga buxheti qendror i Prezencës.

Prezenca ka ndihmuar Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC) për publikimin e kuadrit ligjor, vendimeve për vitin 2004, dhe informacion mbi veprimtaritë e tij në faqen e internetit deri në qershor 2005. Prezenca financoi botimin e Buletinit të KSHC-së, që përfshinte raportin me analizat për rastet e paraqitura pranë tij, vendimet përkatëse dhe rekomandimet në lidhje me shërbimin civil, të cilat u shpërndanë në ministri dhe institucione të tjera shtetërore. Prezenca organizoi për zyrtarët e KSHC-së një vizitë studimore pranë Shkollës së Administratës Kombëtare në Francë për të vëzhguar procedurat franceze të trajtimit të ankesave të nëpunësve civilë.

Në dhënien e asistencës legislative, Prezenca ka ndjekur nismat legislative të Qeverisë, me konsulta proaktive mbi to dhe ka rishikuar e komentuar disa projektligje. Prezenca ka ndihmuar në përgatitjen e një ligji që përcakton moshën e ligjshme për konsumimin e pijeve alkoolike dhe ka rishikuar ligjin e barazisë gjinore. Komentet mbi ndryshimet për ligjin e kthimit dhe kompensimit si dhe mbi projektligjin për legalizimin e ndërtesave të paligjshme janë dorëzuar pranë Kuvendit.

6.2 Të drejtat e njeriut

Prezenca i ka kushtuar vazhdimisht konsideratën e duhur zhvillimeve mbi të drejtat e njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës, duke i sjellë në vëmendje të Qeverisë sipas rastit. Si pjesë e Projektit të Prezencës për Trajnimin mbi Drejtësinë për të Miturit, në qershor 2005, studentë nga Shkolla shqiptare e Magjistraturës bënë një vizitë studimore në Shkollën franceze të Magjistraturës në Paris dhe Bordo. Në nëntor 2005, Prezenca dhe Zyra e Avokatit të Popullit kryesuan një tryezë të rumbullakët për të diskutuar ndryshimet në ligjin për Avokatin e Popullit që duhej të dërgoheshin në Kuvend për miratim. Në nëntor 2005, USAID-i dhe Prezenca bashkëfinancuan një Konferencë Ndërfetare për Evropën Juglindore në Tiranë, me qëllim sigurimin e një forumi ku udhëheqësit fetarë rajonalë të ndanin përvojat për forcimin e harmonisë fetare. Në mars 2005, Prezenca kryesoi takimet e bashkërendimit Qeveri/Donator në lidhje me zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Romëve dhe ra dakord për shpërndarjen e Strategjisë brenda njësive të qeverisjes vendore.

6.3 Reforma zgjedhore

Përbushja e standardeve të respektuara në nivel ndërkombëtar në përgjithësi dhe zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore është një përparësi e qartë për Shqipërinë dhe aspiratën e saj Euro-Atlantike. E kaluara ka treguar se ndërmjetësimi i jashtëm i marrëveshjeve politike për çështje zgjedhore priret të prodhojë rezultate jetëshkurtra, pasi këto marrëveshje ka të ngjarë të vihen në diskutim si të 'imponuara' ose 'të padrejta' dhe, përfundimisht, të mos respektohen. Vullneti real politik i partive shqiptare përbën një parakusht për zgjidhje jetëgjata dhe të respektueshme që duhet të vijnë nga vetë skena politike shqiptare. Duke pasur parasysh këtë gjë, Prezenca ka vazhduar t'i japë mbështetje Qeverisë për përmirësimin e standardeve dhe strukturave, me qëllim sjelljen e zgjedhjeve në përputhje me standarde ndërkombëtare, duke u përqendruar tek ekspertiza teknike dhe ligjore.

Pas zgjedhjeve të korrikut 2005, Prezenca, në bashkëpunim me OSBE/ODIHR-in, filluan të ndjekin çështje kyçe që përcaktojnë besueshmërinë e listave të zgjedhësve shqiptarë. Me kërkesë të Ministrisë së Brendshme (MB), në nëntor 2005, OSBE/ODIHR-i dërgoi komentet e tij mbi planet ministrore për modernizimin e regjistratit të gjendjes civile dhe sistemit të adresave. Konsultime të mëtejshme, që përfshijnë Qeverinë, ODIHR-in dhe Prezencën, kanë vazhduar duke u përqendruar në çështje të pazgjidhura, përfshirë një afat kohor realist për punën që duhet bërë dhe për format e mbështetjes nga Prezenca në këtë proces. Duke pasur parasysh urgjencën, puna për listat e zgjedhësve për zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore, u nis pa lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e modernizimit të shërbimit të gjendjes civile.

Prezenca ka vazhduar t'i japë MB-së asistencë teknike dhe ekspertizë për përgatitjen e listave të zgjedhësve për zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore. Prezenca ka ndihmuar në përgatitjen e projektudhëzimeve për regjistrat e përkohshëm, zgjedhësit e pidentifikuar pa referenca adrese dhe vendndodhje fizike si dhe mbi

fshirjen e të dhënave të shumëfishta nga regjistrat themeltarë. Që nga janari 2006, MB-ja ka organizuar tre seminare për përgatitjen e listës së zgjedhësve me mbështetjen e Prezencës. Këto mblodhën së bashku aktorë nga qeverisja qendrore dhe vendore, administrata zgjedhore, parti politike dhe shoqëria civile. Seminaret trajtuan procedurat për heqjen e rekordeve të shumëfishta nga regjistrat themeltarë dhe përgatitjen e udhëzimeve të Qeverisë për të rregulluar përfundimin e procesit të adresave zgjedhore që ishin të papërfunduara në vitin 2005. Të dyja aspektet ishin pjesë e një projekti të financuar nga BE/USAID-i.

6.4 Ndërtimi i kapaciteteve të Kuvendit

Kuvendi i Shqipërisë është transformuar në një platformë qendrore për debat politik dhe diskutime mbi alternativa dhe propozime. Ndhimesa për këto funksione ka qenë përparësi e punës së Prezencës. Duke pasur parasysh se rregullorja e re e detyron Kuvendin të publikojë zbardhjen e seancave plenare në kohë, në shtator 2005, Prezenca siguroi pajisje regjistrimi të nevojshme për procesin e zbardhjes, dhe instaloi një sallë kompjuterash në Kuvend. Në shtator 2005, Prezenca mbështeti programin orientues të Kuvendit, në mënyrë që deputetët e sapozgjedhur të njiheshin me shërbimet dhe mjediset. Kuvendi ndihmoi, gjithashtu, në organizimin e trajnimit për tridhjetë sekretarë/e të deputetëve në zonat zgjedhore për t'i ndihmuar deputetët të kryejnë detyrat e tyre me më shumë efektshmëri. Një raport mbi mbështetjen për zyrat e deputetëve në zona ofroi rekomandime për funksionimin e tyre në të ardhmen. Në tetor 2005, në bashkëpunim me Kuvendin, Prezenca organizoi seminare për anëtarët e Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financës në lidhje me procedurat buxhetore. Në nëntor 2005, Prezenca përgatiti një vizitë në Kuvendin Suedez për të njëjtët deputetë, për të mësuar më shumë mbi çështjet buxhetore përpara paraqitjes së buxhetit të shtetit. Prezenca organizoi një tryezë pune për drejtuesit e komisionit për modernizimin e sistemit të strukturës së komisionit dhe nisi një kurs gjashtëjavor për hartimin e ligjeve për personelin e komisionit me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre draftuese. Në drejtim të rritjes së transparencës me qytetarët, në mars 2005, Prezenca përgatiti një plan pune të komunikimit për Kuvendin, që përfshinte ridizenjimin dhe përditësimin e faqes së internetit të Kuvendit, për t'i dhënë publikut akses më të gjerë në veprimtaritë e Kuvendit.

Në prill 2006, Prezenca mbështeti organizimin e seminarit mbi praktikën më të mira për mbikëqyrjen e agjencive të shërbimit sekret mbështetur në një manual të përgatitur nga Qendra e Gjenezës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura. Gjithashtu, synimi i seminarit ishte t'iu prezantonte manualin, përkthyer nga Prezenca, parlamentarëve dhe zyrtarëve shqiptarë.

Me kërkesë të Kuvendit, Prezenca siguroi mbështetje për konferencën e përbashkët nga "Rose-Roth" i Asamblesë Parlamentare të NATO-s dhe Shoqata Shqiptare e Atlantikut të Veriut, që u zhvillua në Tiranë, në prill 2006.

6.5 Media

Puna e Prezencës është përqendruar te legjislativi dhe nxitja e standardeve më të larta profesionale dhe etike të medias. Prezenca ka ndjekur zhvillimet rregullatore dhe legjislative dhe ka punuar ngushtë me Përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Medias, i cili bëri komente mbi ligjin e propozuar nga Qeveria mbi organet rregullatore kombëtare të medias elektronike. Prezenca përfundoi një projekt trajnimi, financiar

nga një OJF hollandeze, për dymbëdhjetë stacione televizive lokale. Projekti ishte pjesë e një projekti më të gjerë që synonte ndërtimin e kapaciteteve profesionale. Në nëntor 2005, Instituti Shqiptar i Medias, me mbështetjen e Prezencës dhe USAID-it, bashkëorganizuan një tryezë të rrumbullakët përuruese për fillimin e procesit të krijimit të një Këshilli të Etikës në Media.

Me mbështetje nga Zyra e Avokatit të Popullit dhe qeveria zvicerane, Prezenca ka organizuar që prej janarit 2006 gjashtë tryeza të rrumbullakëta rajonale për të drejtën e informimit, duke sjellë së bashku zyrtarë lokalë dhe përfaqësues të medias për të diskutuar Ligjin për Të drejtën e Informimit mbi Dokumente Zyrtare. Për të ndihmuar rritjen e standarteve të gazetarisë, Prezenca organizoi një projekt mbi zhvillimin e Shkollës së Gazetarisë në Tiranë dhe krijimin e programeve mësimore në përputhje me Deklaratën e Bolonjës. Strategjia e propozuar nga një ekspert i huaj i kontraktuar do të shërbejë tani si bazë për një plan pune në të ardhmen.

6.6 Shoqëria civile

Prezenca ka bashkëpunuar me një spektër të gjerë OJF-sh vendase, kryesisht për çështje të mirëqeverisjes dhe transparencës dhe ka organizuar me to disa projekte në lidhje me zgjedhjet. Rrjeti i Qendrave të Zhvillimit të Shoqërisë Civile (QZSHHC) ka vazhduar të çlirohet nga Prezenca dhe, pas marrjes së statusit ligjor në vitin 2005, do të bëhen të pavarura nga Prezenca në fund të vitit 2006. Menaxhimi dhe qëndrueshmëria e QZSHHC-ve pas këtij afati është në qendër të një projekti jashtëbuxhetor në vazhdim. QZSHHC-të kanë siguruar mbështetje logjistike për vëzhguesit e zgjedhjeve për Kuvendin në korrik 2005 dhe kanë shërbyer si platformë për një sërë veprimtarish me përfshirje të OJF-ve kombëtare dhe grupe të shoqërisë civile.

Në prill 2006, Prezenca nisi një projekt për ndërtimin e kapaciteteve të informimit të publikut për organizata të shoqërisë civile dhe organizata të bazuara në komunitet. Këto veprimtari kanë synuar forcimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të shoqërisë civile për të luajtur një rol më të madh në procesin demokratik. Prezenca ka vazhduar të mbështesë *zbatimin e Strategjisë kombëtare për njerëzit me aftësi të kufizuara* dhe ka bashkëpunuar me përfaqësues të Qeverisë për të identifikuar përparësitë për zbatimin e kësaj strategjie.

6.7 Çështje gjinore

Prezenca i ka dhënë mbështetje teknike Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) për rihartimin e Ligjit për Barazi Gjinore. Prezenca dhe PNUD-i kanë rënë dakord me MPÇSSHB-në për një rishikim me qëllim ndryshimin e Ligjit për Barazi Gjinore. Puna është bashkërenduar me hartimin aktual të një ligji për Antidiskriminimin, me qëllim harmonizimin e përpjekjeve për nxitjen e mundësive të barabarta. Në qershor 2005, Prezenca hapi Qendrën e Këshillimit të Grave në Kukës nëpërmjet një financimi nga qeveria gjermane. Kjo qendër ka siguruar deri tani shërbime këshillimi për më shumë se 300 gra – kryesisht nga zona rurale të Shqipërisë së Veriut. Prezenca ka luajtur, gjithashtu, një rol udhëheqës në bashkërendimin e donatorëve në fushën e barazisë gjinore.

7. E ARDHMJA

Viti 2007 do të jetë i rëndësishëm për Shqipërinë që të konsolidojë përparimin drejt një qeverisjeje më të mirë dhe arritjen e rezultateve në reformat e shpallura publike në mbështetje të vazhdimit të progresit drejt integritimit në BE. Përgatitjet e rregullta dhe zhvillimi i zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, që tani priten të zhvillohen në fillim të vitit 2007, do të jenë një provë kyçe e aftësive të aktorëve politikë për arritjen e mirëkuptimit për çështje të interesit kombëtar. Prezenca dhe të gjitha institucionet e tjera të OSBE-së do të vazhdojnë të punojnë në partneritet me Qeverinë për forcimin e fushave të përcaktuara brenda Mandatit aktual.

Në kuadrin e programit të bashkëpunimit për sigurinë, Prezenca do të përqendrohet ekskluzivisht në asistencën për Policinë. Kjo mbështetje për policinë kufitare do të jepet nëpërmjet trajnimit dhe asistencës teknike në menaxhimin ndër-kufitar dhe në zbatimin e aspekteve të antitrafikimit. Këto veprimtari do të vazhdojnë të bashkërendohen nga afër me partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

Në programin e saj për mirëqeverisje në çështje të ekonomisë dhe mjedisit, Prezenca do të ndihmojë Qeverinë në vazhdimin e programit të reformës për pronat. Prezenca do të vazhdojë të mbështesë zbatimin e Planveprimit kombëtar kundër trafikimit dhe të punojë, në këtë kontekst, me OCEEA-n dhe ODIHR-in për një program dyvjeçar për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet forcimit ekonomik dhe masave për mbrojtjen e viktimave.

Brenda programit të dimensionit njerëzor, Prezenca do t'i japë Qeverisë ekspertizë në hartimin legjislativ, përmirësimin e mëtejshëm të listave të zgjedhësve si dhe në gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme të problemeve të regjistrimit të zgjedhësve nëpërmjet krijimit të një sistemi funksionues të Regjistratit Civil dhe lidhjes së tij me një sistem të besueshëm adresash. Prezenca ka propozuar të vazhdojë të punojë me Kuvendin për të çuar më tej praktika parlamentare efektive dhe profesionale në kuadrin e një projekti mbështetës shumëvjeçar jashtëbuxhetor. Prezenca do të përqendrohet në çuarjen më tej të bashkëpunimit midis shoqërisë civile dhe strukturave qeveritare, përfshirë zhvillimin e një strategjie kombëtare për barazinë gjinore. Prezenca do të ndihmojë Këshillin për Etikën në Media që të zhvillojë standarde vetërregulluese etike dhe profesionale.

Në lidhje me reformën gjyqësore dhe legjislativë, Prezenca do të punojë për vëzhgimin e gjykimeve, monitorimin e hetimeve para gjykimit, apelimet penale dhe gjykimet në çështjet civile. Prezenca do të punojë, gjithashtu, për përmirësimin e standardeve të etikës gjyqësore dhe transparencës brenda gjyqësorit. Prezenca do të vazhdojë të punojë me institucionet shqiptare për zhvillimin legjislativ në kuadrin e integritimit në BE në rastet kur lidhet me mandatin e Prezencës. Prezenca do të përqendrohet, gjithashtu, te të drejtat e komunitetit rom.

Prezenca do të vazhdojë të veprojë në fushat kryesore të mandatuarat të saj, duke forcuar më tej konsultimet me Qeverinë dhe institucione të tjera shtetërore për të maksimizuar mbështetjen e saj për reforma në vend dhe përparim në integritimin Euro-Atlantik. Puna e Prezencës do të forcohet më tej me përdorimin e kapaciteve që të gjitha institucionet e OSBE-së mund të japin, si dhe me ndërtimin e bashkëpunimit më të afërt me misione të tjera të OSBE-së në rajon. Prezenca do të ruajë në 2007 strukturën ekzistuese të programeve kryesore të ngritura në 2006. Katër zyrat rajonale do të shndërrohen në zyra

projektesh dhe do të zbatojnë projekte në nivel kombëtar dhe rajonal të drejtuara nga Prezenca. Kuadri i propozuar i buxhetit për vitin 2007 do të jetë afërsisht 2 për qind më i ulët se në vitin 2006. Prezenca do të vazhdojë të tërheqë fonde të konsiderueshme jashtëbuxhetore dhe do të kërkojë maksimizimin e përdorimit të fondeve nga buxheti i unifikuar për qëllime tematike.

Vitin e kaluar, erdhi në pushtet një Qeveri e re që ka ambicie të qartë për përshejtimin e hapave për reformat në vend. Për të çimentuar më tej marrëdhënien bashkëpunuese të vendosur tashmë me Qeverinë, me vëmendje të veçantë në përparësitë strategjike të Qeverisë, Prezenca do të vazhdojë të konsultohet nga afër me Qeverinë dhe partnerë të tjerë shqiptarë. Gjithshtu, ajo do të mbështetet te transparenca dhe gatishmëria e Qeverisë, ku dhënia në kohë e informacionit përkatës nga ana e saj është një prej parakushteve për maksimizimin e efektit të asistencës së dhënë nga Prezenca. Prezenca është e gatshme, gjithashtu, për t'u konsultuar më tej me Qeverinë në lidhje me planifikimin kyç dhe dokumentet e projekteve që udhëheqin punën e Prezencës si dhe mbi vizionin afatmesëm dhe afatgjatë për Prezencën e OSBE-së.